



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPKI	Nr. Prot. 06-01/4516/2
Dep. 03	Pr. No. 10.11.2022
Nr. Fila	Dga
Bro. Fila	Datum
Nr. pages	Data



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, nenit 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 09.11.2022, Drejtori i Agjencisë Për Parandalimin e Korrupsionit mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr.AKK-DPKI-06-3935/22, për zyrtaren e lartë znj. Narqize Arënliu Hoxhaj, Drejtoreshë e Përgjithshme, Spitali i Përgjithshëm Prizren, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokollit AKK-DPKI- 06-3935/22,që për trajtim ka pasur zyrtaren e lartë znj. Narqize Arënliu Hoxhaj, Drejtoreshë e Përgjithshme, Spitali i Përgjithshëm Prizren, është zhvilluar procedura e paraparë për trajtimin e situatave të konfliktit të Interesit.

Ky rast ka filluar të trajtohet, sipas detyrës zyrtare pas informacioneve të pranuar nga jashtë ku është dyshuar se zyrtarja e lartë, respektivisht, Drejtoreshë e Përgjithshme, Spitalit të Përgjithshëm në Prizren, figuron të jetë pronare dhe person i Autorizuar në biznesin me emër Ordinanca Stomatologjike “Nardent”.

Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), sipas procedurës fillimisht ka verifikuar informacionin duke marrë edhe informacione nga ARBK-ë (Agjencia Për Regjistrimin e Bizneseve), e ku pastaj është konfirmuar se zyrtarja në fjalë, figuron të jetë pronare edhe person i autorizuar në bizneset privat .

Agjencia Për Parandalimin e Korrupsionit, sipas procedurës së paraparë, fillimisht e ka njoftuar zyrtaren e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtarja Narqize Arënliu Hoxhaj, ka kontaktuar me zyrtarët e APK-së, dhe ka kërkuar sqarime sa i përket shkresës së dërguar dhe mundësin që të ketë një takim për tu njoftuar për rastin e iniciuar për të, e ku pastaj në zyrat e APK-së, është mbajtur edhe një takim informuese, më këtë rast zyrtaret e APK-së e kanë njoftuar atë me iniciimin e rastit, si dhe e kanë njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtare e lartë, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksion drejtues, respektivisht, menaxhues në biznesin privat, sepse kjo është e ndaluar me neni 13 (paragrafi 1) të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilën thuhet:

1. *Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.*

Ndërsa me nenin 19 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. *Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:*
 - 1.1. *transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];*
 - 1.3. *jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;*
 - 1.4. *dorëhiqet nga funksioni publik.*

Gjatë këtij takimi, të quajtur ndryshe edhe si ballafaqim i fakteve, zyrtarja e lartë, ka deklaruar se se nuk ka pas njohuri në lidhje me kufizimet e tilla, me gjithë atë, është zotuar se ne afatin metë shkurtër do të ndërmerr veprime të menjëhershme në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrim të funksionit publik.

Në ndërkohë, Agjencia ka pranuar, informacionin nga znj. Narqize Arënliu Hoxhaj, me të cilën na ka njoftuar se ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe ka transferuar të drejtat e administrimit dhe




menaxhimit, të biznesit tek personi i besuar, kjo dëshmohet edhe nga informata mbi biznesin (06-01/4141-1/22), të lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Agjencia Për Parandalimin e Korrupsionit, konstaton se me veprimet e ndërmarra dhe dëshmitë e ofruara nga zyrtarja e lartë, znj. Narqize Arënliu Hoxhaj, Drejtoreshë e Përgjithshme, Spitali i Përgjithshëm Prizren, duke ndërmarra veprimet e nevojshme duke transferuar të drejtat e administrimit dhe menaxhimit, të biznesit privat tek personi i besuar, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-17 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Agjencisë Për Parandalimin e Korrupsionit